



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 24 mars 2014
Nr.ref.:RK579/14

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI90/13

Parashtrues

Lumni Limaj

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Panelit për Lirim me
Kusht në Ministrinë e Drejtësisë, MD/PLK. Nr. 457/12,
të 28 dhjetorit 2012**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Lumni Limaj nga Prizreni (në tekstin e mëtejme: parashtruesi), i cili gjendet në vuajtje të dënimit në burgun e Dubravës.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktvendimi i Panelit për Lirim me Kusht i Ministrisë së Drejtësisë, MD/PLK. Nr. 457/12, i 28 dhjetorit 2012, të cilin parashtruesi e ka pranuar më 29 janar 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit i Panelit për Lirim me Kusht i Ministrisë së Drejtësisë, MD/PLK. Nr. 457/12, i 28 dhjetorit 2012, që ka të bëjë me procedurën penale, në të cilin rast parashtruesi i kërkesës ishte shpallur fajtor për veprën penale vjedhje grabitçare dhe i dënua me burgim prej dhjetë (10) vitesh.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 56, paragrafi 2, të Rregullores së punës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 5 maj 2013, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi një shkresë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 24 maj 2013, Gjykata kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që ta plotësojë formularin zyrtar të Gjykatës për regjistrim të kërkesës.
7. Më 24 qershor 2013, parashtruesi e dorëzoi në Gjykatë formularin zyrtar të Gjykatës për regjistrim të kërkesës.
8. Më 28 qershor 2013, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. GJR. KI90/13, caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin Nr. KSH. KI90/13, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Ivan Čukalović.
9. Më 3 korrik 2013, Gjykata Kushtetuese kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që sërish të plotësojë formularin zyrtar të Gjykatës për regjistrim të kërkesës dhe të njëjtin ta nënshkruajë pasi që formulari i 24 qershorit 2013 nuk është i nënshkruar, dhe të saktësojë se cilin vendim e konteston.
10. Më 20 janar 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin paraprak të gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës për papranueshmëri të kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 21 mars 2007, Gjykata Supreme e Kosovës, duke vendosur në bazë të ankesës së mbrojtësit të parashtruesit të kërkesës dhe mbrojtësve të dënuarve të tjerë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Ap. nr. 186/2006, të 14

shtatorit 2006, nxori Aktgjykimin API. nr. 9/2006, përmes të cilit refuzon ankesën si të pabazuar, vërteton pjesën gjyquese të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Ap. nr. 186/2006, të 14 shtatorit 2006, dhe për pjesët e tjera të aktgjykimit ankesën e parashtruesit e hedh si të palejuar.

12. Gjykata Supreme më tej në arsyetimin e saj thekson:

“Duke vlerësuar Aktgjykimin e kundërshtuar përkitazi me shkeljet qenësore të dispozitave të procedurës penale, konform dispozitës së nenit 415 të KPPPK, Gjykata Supreme vlerëson se ky aktgjykim nuk përmban shkelje qenësore të dispozitave të procedurës penale e as shkelje të ligjit penal, shkelje këto të cilat Gjykata i vëren detyrimisht e të cilat do të kushtëzonin anulimin e Aktgjykimit”.

13. Më 20 dhjetor 2010, Gjykata Supreme e Kosovës, duke vepruar në bazë të kërkesës së parashtruesit të kërkesës për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit, nxori Aktvendimin Pzd. Nr. 128/2010, duke e refuzuar si të pabazuar kërkesën e parashtruesit. Gjykata Supreme më tej në aktvendim thekson:

“Rrethanat e lartë cekura lehtësuese të theksuara në kërkesën për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit nuk janë të asaj natyre që konform dispozitës së nenit 448 të KPPK, të merën si bazë për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit, e sidomos duke i pasur parasysh rrethanat dhe mënyrën e kryerjes së veprave penale...”.

14. Më 28 dhjetor 2012, Ministria e Drejtësisë, përkatësisht Paneli për Lirim me Kusht, duke vepruar në bazë të kërkesës për lirim me kusht, nxori Aktvendimin MD/PLK. Nr 457/12, me të cilin refuzoi kërkesën për lirim me kusht me arsyetimin:

“Nuk është arritur risocializimi, duke marrë për bazë mendimin përmbledhës të qendrës korrektuese mbi shkallën e risocializimit. Paneli vlerëson se nuk është arritur qëllimi i dënimit konform nenit 34 KPK-së kështu që kërkesa e tij refuzohet me mundësi rishqyrtimit në 1 vjet”.

Pretendimet e parashtruesit

15. Parashtruesi i kërkesës nuk ka saktësuar shkeljen e pretenduar të ndonjë dispozite kushtetuese në veçanti.

Pranueshmëria e kërkesës

16. Për të qenë në gjendje të shqyrtojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata Kushtetuese para së gjithash duhet të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

17. Në këtë drejtim, neni 113, paragrafi 7, i Kushtetutës parasheh:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

18. Përveç kësaj, Gjykata i referohet nenit 48 të Ligjit, që parasheh:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

19. Lidhur me kërkesën, parashtruesi nuk ka saktësuar se cilin vendim të gjykatave e konteston dhe cilat të drejta dhe liri të garantuara me Kushtetutë pretendon se i janë shkelur ashtu siç parashihet në nenin 113.7 të Kushtetutës, dhe nenin 48 të Ligjit. Duke marrë parasysh se barra e të provuarit të shkeljeve kushtetuese bie mbi parashtruesin e kërkesës, Gjykata do të shqyrtojë vetëm dokumentacionin e bashkëngjitur me kërkesën. Në rastin konkret parashtruesi nuk ka arritur të paraqes prova nga të cilat Gjykatën do ta dërgonin në përfundim të shkeljes eventuale të ndonjë dispozite kushtetuese.
20. Për më tepër, Gjykata Kushtetuese nuk mund të zëvendësojë rolin e gjykatave të rregullta. Është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, García Ruiz kundër Spanjës [DHM], nr. 30544/96, paragrafi 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).
21. Parashtruesi i kërkesës po ashtu nuk paraqiti ndonjë dëshmi *prima facie* që do të tregonte shkeljen e të drejtave të tij kushtetuese (shih, *mutatis mutandis*, Vanek kundër Republikës së Sllovakisë, Vendimi i GJEDNJ-së lidhur me pranueshmërinë e kërkesës, nr. 53363/99, i 31 majit 2005).
22. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar në pajtim me rregullin 36 (2) a) dhe d) të Rregullores së punës që parasheh: *“Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar nëse: a) kërkesa nuk arsyetohet prima facie dhe d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.*

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në përputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 36 (2) a) dhe d) të Rregullores së punës, më 20 janar 2014, njëzëri:

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Dr. Kadri Kryeziu



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. dr. Enver Hasani